



---

## Biografi e shkurtër

---

Znj. Lorena Ruçi është diplomuar në vitin 2011 për Administrim - Biznes në Universitetin “Yeditepe” Stamboll, Turqi ku është vlerësuar me “Medalje Ari”. Në vitin 2012, ka përfunduar studimet Master në Administrim Biznes (MBA) po në Universitetin “Yeditepe” Stamboll, Turqi, ku u vlerësua me titullin “Nderime të Larta”.

Në vitin 2013 ka punuar si specialiste finance pranë Union Grup shpk e më pas për gati 8 vjet ka vijuar si përgjegjëse e zyrës së financës në Universitetin “Luarasi”.

Në periudhën 2017 – 2019 ka kryer detyrën e menaxheres financiare në projektin “Klinika Ligjore Luarasi” të Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë. Në vijim, Qershor 2020 – Qershor 2021 ka qenë menaxhere financiare në projektin "Forcimi i shkëmbimit akademik dhe kërkimor rajonal" të Fondit të Ballkanit Perëndimor, projekt i Universitetit Luarasi.

Znj. Ruçi ka kryer një sërë trajnimesh për përdorimin e programeve financiare dhe zotëron Patentën Europiane të Kompjuterit (ECDL) për katër module. Është njohëse e gjuhëve Anglisht, Italisht dhe Turqisht.

Aktualisht mban pozicionin e këshilltares ekonomike, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.